




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-7216/20 datë: 05.05.2020



Npi – 01/92 datë: 08.05.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 08.05.2020 nxjerr këtë:

E K STRAKT
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 08.05.2020 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Syla, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtoret, z.Halil Halili; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Propozim-Vendim për rritjen e Kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake,
2. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020,
3. Propozim-Vendim për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hap diskutimin për rendin e ditës tha: Për fat të mirë fazën më të rëndë të Pandemisë KOVID19 e kaluam, kështu që tani më jemi në fazën kur nuk ka të infektuar me korona virus. Por lus që edhe më tutje të kemi kujdes të shtuar sepse mund të rikthehet. Në vazhdim po hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, një përshëndetje e vegantë për znj.Kimete Ukaj që u rikthyen si Zyrtare Kryesore Financiare, të ciklës i uroj punë të mbarë. Unë e përkrahu rendin e ditës.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, uroj mirseardhje Kimete Ukaj, edhe po ashtu uroj që pandemia të largohet krejtësisht sa më parë. Ka pyetje nga qytetarët për drejtorin Halil Halilin, por do ti dorëzoj pyetjet.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, unë i uroj mirseardhje Kimete Ukaj, dhe uroj që ajo të jetë vetvetja. Te rendi i ditës, ne kemi procesverbal pse mos me e shti në rendin e ditës sepse dikur kur të hijet Pandemia ne i harrojmë krejt. Unë e di që zyrtari i Kuvendit z.Idajet Rexhepi e ka punuar procesverbalin, pse mos me e shti në rendin e ditës.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi, se ne kemi folë me MAPL-në dhe ata na kanë thënë se nuk, shqyrtojnë vendime tjera përveq atyre që kanë të bëjnë me financat. Kjo nënkupton se në rendin e ditës nuk mund të fisim pika tjera përveq atyre financiare.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.

Pika 1

Propozim-Vendim pér rritjen e Kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën pér prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Ju falënderoj pér urimet që mi bëtë. Në vazhdim ajo tha se ne kemi propozuar këtë pikë të rendit të ditës me qëllim që me e rritë Kulmin Buxhetor pér vitin 2019 me qëllim që ta hapim mundësinë pér ti shfrytëzuar shumën e mjeteve financiare prej 21,248.40€ të grumbulluara nga të hyrat vetanake muajin e fundit të vitit 2019. Kulmi buxhetor me këto mjete do të rritet në 525,130.00€. Dokumentin e propozuar nga ekzekutivi e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar, kështu që nuk do ta zgjati më shum por jam këtu pér ndonjë pyetje eventuale,(shih dokumentin).

z.Naim Zejna; Mirë është që kemi rritje të të hyrave vetanake. Pyetje pér ZKF-në, a është kjo ndarje e njejtë me shumën prej 21,240.40€ ?

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Po te ndarja është përfshirë shuma e njëjtë.

z.Ruzhdi Jashari; A janë në planifikim këto ndarje? Dhe pyetja tjetër Donacionet a janë të përfshira në këtë ndarje në shumën prej 525,130.00€?

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Këto të hyra janë nga të hyrat indirekte, dhe nuk kanë qenë të planikuara.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti pér Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekmandoj Kuvendit aprovimin e Propozim-Vendimit pér rritjen e kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake në shumën prej 525,130.00€.**

Pika 2

Propozim-Vendim pér ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën pér prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Prezantoj këtë pikë para KPF-së sipas shifrave në Propozim-Vendim. Dokumentin e keni të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, nëse ka ndonjë pyetje jam këtu pér tu përgjigjur, (shih dokumentin).

z.Naim Zejna; Te pozicionet 9 dhe 13 duhet me i bërë 9, 10 e mos me e humbë renditjen. Mjetet nuk janë të arsyetuara bash taman, mirëpo e rezervojmë të drejtën që në Kuvend me diskutuar më detalisht, pér me qitë ndonjë projekt më konkret.

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Sqaroi lidhur me pozicionin e performancës.

z.Ruzhdi Jashari; Po shihet që pwerforma në vitin 2019 nuk ishte në nivelin e duhur. Rreth 100.000€ i kemi nda pér Pandeminë KOVID19 nëse hiqen këto po na mbisin edhe diqka mbi 130.000€ e të cilat një pakicë shkojnë te kapitalet ndërsa të tjerat te shërbimet dhe mallrat. E kuptoj që ka kërkesa të mëdha, por i ke qitë 6 pozicione te ky kod buxhetor. Këto janë vërejtjet tona.

z.Perparim Ramusa; Te kjo pikë pajtohem i përmendem që kemi marrë përshtatje pér këtë ndarje. Po ndalem te projektet veq e veq, te Administrata i kanë ndarë 25.000€ kur e dimë që në shumëcën e kohës janë mbyllur, Qerdhja është mbyllur, ndërsa te shëndetësia pajtohem. Kështu që unë propozoj që deri më 14 në mbledhjen e Kuvendit të mendojmë mirë, unë kisha propozuar që shumica të shkojnë në infrastrukturë.

zpj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Ne kemi një vendim të Kuvendit pér ndarjen e 100.000€ pér pandeminë KOVID19, ku thuhet që mjetet kthehen nga të hyrat vetanake. Te Subvencionet është bërë një ndarje pér ndihmë fermerëve me një shumë prej 10.000€. Te shërbimet sociale nuk kemi pas mundësi me lëvizë shumë.

z.Perparim Ramusa; Meqenëse po del se 100.000€ pér pandeminë i paskemi marrë hua, unë po pajtohem me këtë ndarje.

z.Ruzhdi Jashari; Ne e dimë që i kemi marrë paret nga kode të ndryshme buxhetore si te administrata etj. ky pra është një arsyetim, por pér sa i përket zhvillimit është te kapitalet. Kemi kodin e njejt edhe te pagat e që dmth. është i njejti kod.

z. Naim Zejna; Atë që e pashë më parë te shëndetësia e kemi të njejtin kod, por siq thash më parë e ruaj të drejtën që në Kuvend me diskutuar më detalisht.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje. * Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Propozim-Vendimit për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020.

Pika 3

Propozim-Vendim për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Fitim Hoxha.

z. Fitim Hoxha, drejtor i DZHE; Pasi përshtëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi këtë pikë duke e lexuar dokumentin. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë, nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur. Ju ftoj që ti rekandomani Kuvendit për aprovim, (shih dokumentin).

z. Naim Zejna; Faleminderit për prezantimin. Te preambula duhet të shkruhet edhe për personat fizik e jo vetëm për ata juridik. Kam nj pyetje për drejtorin se a ka ndonjë taksë tjeter që eventualisht ka mbetur jashtë pa u përfshirë me qëllim që mos me intervenuar prap?

z. Ruzhdhi Jashari; Janë identifikuar 6 veprimtari që po lirohen nga taksat komunale, por siq e dini i kemi edhe auto-taksitë dhe autobusët që nuk është futur si kategori për tu liruar e që unë mendoj se edhe këta duhet të futen e pastaj të shkojë në Kuvend si rekandomdim.

z. Halil Halili, drejtor i DSHP; Përshtëndetje, unë desha ta jap një sqarim lidhur me pyetjen e Ruzhdiut. Ne sigurisht që e bashkëndjejmë këtë gjendje të pandemisë bashkë me ta por realisht ne nuk kemi se si ti lirojmë dhe të ju ndihmojmë edhe këtyre, sepse ata për vendqëndrimet e tyre nuk paguajn kurfar takse, përveq se vazhdimit të lejes së punës por ajo bëhet kur të vie koha e vazhdimit të lejeve varësisht nga personi kur e ka marrë ose kur e ka vazhduar lejen për herën e fundit. Kështu që këta faktikisht nuk kemi se si ti lirojmë.

z. Perparim Ramusa; E falënderojmë drejtorin për sqarimet që na i dha, kështu që unë pajtohem me Propozim-Vendimin, dhe do ta votojë.

z. Fitim Hoxha, drejtor i DZHE; Sa i përket propozimit të Naim Zejna, që të futet edhe për personat fizik, ne do ta përmirësojmë për mbledhjen e Kuvendit. Ky propozim është i analizuar mirë, kështu që kemi ndikuar aty ku kemi pas mundësi, sipas mundësisë ligjore e që është bërë me rregulloren për taksat komunale.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Propozoj që ta ndryshojmë formulimin e kësaj pike dhe ti shtohet në fund edhe fjala "dhe fizik". Në vazhdim Kryesuesja Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që të ndryshohet formulimi i kësaj pike të rendit të ditës ku Propozim-Vendimt për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik i shtohet edhe fjala "dhe Fizik".

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht i Rekomandon Kuvendit aprovimin e Propozim-Vendim për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik duke ja shtuar edhe fjalën "dhe personat fizik".

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi ne ora 10.58h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj